



***Projekti CSS për Ndërmjetësim Integrativ***

***Dokument për Diskutim***

***Komitetet për Komunitete dhe për Ndërmjetësim në  
Kosovë***

***shkurt 2006***



Stabilitätspakt für Südosteuropa  
Gefördert durch Deutschland  
Stability Pact for South Eastern Europe  
Sponsored by Germany

## Ndërmjetësimi Integrativ: Afrimi i Udheheqësve Lokal

ëç

Projekti CSS për Ndërmjetësim Integrativ u krijua nga dhjetë vitet e përvojës së Ndërmjetësuesit Ndërkombëtar në Bosnjë e Hercegovinë, Dr. Christian Schwarz-Schilling. Puna e Ndërmjetësuesit filloi joformalisht më 1992 dhe fitoi mandatin formal nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga popujt e Bosnjë e Hercegovinës prej 1995 deri 2004. Sipas kërkesës, formati dhe struktura e ndërmjetësuesve janë kryer në nivel lokal bazuar në nevojat praktike dhe konflikte lokale. Ndërmjetësuesi kërkonte rritjen e dialogut dhe zvogëlimin e tensioneve duke gjetur zgjidhje hap pas hapi për probleme ditore. Format i procesit përfshiu vizita informuese, ndërmjetësime, vizita pasuese dhe tryeza të rrumbullakëta. Gjatë 10 viteve të punës Ndërmjetësuesi kreu më shumë se 185 ndërmjetësime lokale në 55 komuna. Mandati i Ndërmjetësuesit përfundoi në dhjetor 2004.

Ndërmjetësimi Integrativ synon të aplikojë mësimet e mësuara dhe të adaptojë modelin unik të Bosnjës për një përdorim të mundshëm në pjesët tjera të Evropës juglindore. Ekipi për ndërmjetësim ka zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj ndërmjetësimit duke përfshirë nivele të ndryshme të përgjegjësisë, akterë të shumtë dhe një mori teknikash. Kjo qasje kombinon gjashtë aktivitete të ndryshme të zgjidhjes së konfliktit, të bazuara në ndërmjetësimin klasik duke zhvilluar njëkohësisht një instrument të kompletuar dhe të decentralizuar për implementimin e marrëveshjeve. Elementet e Ndërmjetësimit Integrativ janë ndërmjetësimi në nivel lokal, vetë-ndërmjetësimi, trajnimi mbi ndërmjetësim, punëtoritë për zgjidhjen e problemeve, pajtimi, dhe hulumtimi/analizat. Gjatë tërë procesit, ai u ndihmon akterëve lokal të zhvillojnë iniciativa dhe të zbatojnë masa për ngritjen e besimit. Përveç kësaj, ai u ndihmon bashkësive të marrin pjesë aktive në procesin lokal të paqes. Për më tepër, ai e zbret procesin e përgjithshëm dhe hierarkik të zgjidhjes së konfliktit në nivel lokal.

Ndërmjetësimi Integrativ nuk synon të zëvendësojë apo të largojë pronësinë e procesit të paqes. Në vend të kësaj, duke e plotësuar procesin e paqes Ndërmjetësimi Integrativ u ofron palëve lokale një kornizë që u mundëson atyre vetë t'i identifikojnë pengesat në zgjidhjen e konfliktit dhe ato të përpjekjeve për pajtim. Synimi kryesor i Ndërmjetësimit Integrativ është që t'i lë vendimet dhe zgjidhjet në duart e akterëve lokal dhe të forcojë punën e nismave lokale për paqe, duke mundësuar në këtë mënyrë kthimin, bashkejetesën dhe reintegrimin në nivel lokal.

### **Për informata të mëtejme kontaktoni:**

CSSProject for Integrative Mediation  
Deutscher Bundestag  
Platz der Republik 1  
11011 Berlin, Germany

[info@cssproject.org](mailto:info@cssproject.org)  
[www.cssproject.org](http://www.cssproject.org)  
tel: +49 30 227 77417  
fax: +49 30 227 76417

## PËRMBAJTJA

<b>PARAFJALA</b> .....	<b>1</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>2</b>
<b>PARAKUSHTET PËR FUNKSIONIMIN E DUHUR TË KOMITETEVE</b> .....	<b>3</b>
<b>KOMITETET PËR KOMUNITETE DHE PËR NDËRMJETËSIM</b> .....	<b>6</b>
KOMITETI I KOMUNITETEVE.....	7
KOMITETI PËR NDËRMJETËSIM.....	9
<b>KRIJIMI I OPCIONEVE</b> .....	<b>12</b>
OPCIONI 1: KOMITETET E NDARA.....	13
OPCIONI 2: KOMITETI I PËRBASHKËT .....	15
OPCIONI 3: DHËNIA NËN KONTRATË E NDËRMJETËSIMIT KOMUNAL .....	17
<b>KONKLUZIONI</b> .....	<b>19</b>
SHTOJCA .....	20
PYETJET PËR DISKUTIMIN E NDËRMJETËSIMIT NË KOSOVË .....	20

## **Parafjala**

Ekipi i CSSP-së arriti në Kosovë për vazhdimësinë e aktiviteteve të vitit 2005 më 22 janar 2006, një ditë pasi Kryetari i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, ndërroi jetë. Me vdekjen e Dr. Rugovës, në Kosovë përfundoi një erë. Gjatë tërë viteve të nëntëdhjeta dhe në periudhën pas konfliktit të vitit 1999, Dr. Rugova ishte një simbol i rezistencës jo të dhunshme dhe i aspiratës së shqiptarëve të Kosovës për një shtet të pavarur. Vdekja e tij i bëri të gjithë të pyesin se çfarë do të ndodh pastaj në një rajon ende nën mbikëqyrjen ndërkombëtare që kërkon të krijojë një kornizë për vetë-qeverisje bazuar në demokraci, tregun e lirë, sundimin e ligjit dhe persepektivën evropiane. Dr. Rugova është dashur t'i udhëhiqte negociatat e shqiptarëve të Kosovës mbi statusin e ardhshëm të saj, të cilat ishin caktuar të fillonin javën që ai vdiq. Takimet ishin shtyrë deri në shkurt për të mundësuar një periudhë zyrtare të zisë dhe një riorganizim politik. Për të gjitha palët javët në vazhdim do të jenë sfiduese. CSSP shpreh ngushëllime të sinqerta familjes së Dr. Rugovës dhe tërë popullit të Kosovës.

## Hyrje

Institucionet e Përkohshme të Vetë-qeverisjes (IPVQ) në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare janë angazhuar për krijimin e një modeli për mbrojtjen e të drejtave që synon t'i shmangët sfidave dhe problemve të krijuara në rajonet tjera. Qëllimi në Kosovë është të zhvillohet një mekanizëm në nivel lokal që i mundëson çdo individ të drejtën të parashtrijë ankesa për diskriminim bazuar në përkatësinë e tij ndonjë bashkësie të caktuar dhe t'i ofrojë bashkësisë shumicë një mundësi të reagojë në këto aneksa në një ambient jo të dhunshëm e problem zgjidhës. Me këtë qëllim, në nivel të komunës janë vënë në zbatim mekanizma të shumtë siç janë ndarja e barabartë e fondeve, Komitetet për Komunitete dhe Ndërmjetësim, si dhe Zyret për Bashkësi për të mundësuar mbrojtjen dhe pjesëmarrjen aktive të të gjitha bashkësive në strukturat komunale. E një rëndësie të veçantë ishin ndërlidhja dhe funksionimi i duhur i Komiteteve për Komunitete dhe atyre për Ndërmjetësim. Të dy këto komitete komunale kanë fituar mandatin me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 dhe funksionimi i tyre është ndryshuar dhe azhurnuar me Udhëzimin Administrativ të UNMIK në vitet 2003, 2004 dhe 2005. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, Komiteti për Komunitete duhet të kujdeset që individët të mos diskriminohen për shkak të përkatësisë në ndonjë bashkësi, dhe se çdo individ të gëzojë të drejtat e barabarta dhe mundësi të barabarta të punësimit në institucione komunale. Për më tepër, Komiteti i Komuniteteve është i ngarkuar me përgjegjësi të hetimit të pohimeve për shkeljen e të drejtave dhe me avancimin e të drejtave dhe interesave të të gjitha bashkësive.<sup>1</sup> Komiteti për Ndërmjetësim, me kërkesë të Komitetit për Komunitete, i heton ankesat mbi shkeljen e të drejtave dhe kërkon zgjidhje përmes "ndërmjetësimit". Mirëpo, problemet me këto komitete ishin të shumta duke krijuar një pakënaqësi të përgjithshme me punën e komiteteve.

### Vrojtim

Mund të identifikohen katër faktorë të rëndësishëm strukturorë si shkaqe rrënjësore për mosfunksionimin e Komiteteve për Komunitete dhe Ndërmjetësim:

- (1) natyra komplekse dhe pritjet e mëdha nga procesi,
- (2) mosnjohja dhe moskuptimi sesi funksionojnë proceset e tilla,
- (3) mungesa e resurseve adekuate, dhe
- (4) mungesa e vullnetit dhe përgjegjësisë politike.

Kombinimi i katër faktorëve të lartpërmendur ka shpër tek rezultatet e dobëta në përgjithësi dhe kah një skepticizëm në aftësitë e komitetit për të mbrojtur dhe avancuar interesat e komiteteve. Aktualisht IPVQ-ja dhe organizatat ndërkombëtare janë duke e rishqyrtuar punën e këtyre komiteteve dhe do të kërkojnë një remont të strukturave dhe funksioneve të komiteteve në përpjekje për të rigjallëruar dhe forcuar qëllimet e mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave individuale dhe atyre të komuniteteve. Një reformë e cila nuk i shtjellon problemet e lartpërmendura strukturorë do të ballafaqohet me problemet e njëjta dhe do të thellojë edhe më tej skepticizimin në komitete dhe aftësinë e institucioneve lokale për t'u ballafaquar me

problemet e diskriminimit. Edhe pse ka shumë për t'u thënë për faktorët e lartpërmendur, ky raport do të përqendrohet vetëm në komentet themelore për t'i prezantuar idetë e ndryshme që do të mund të mirreshin parasysht.

## Parakushtet për funksionimin e duhur të Komiteteve

Ashtu siç është përmendur në raportet paraprake të CSSP-së, strukturat aktuale dhe parimet udhëheqëse të komiteteve janë në teori shumë të dobishme për një shoqëri që ka shumicën e gurthemeleve demokratike në vend. Mirëpo, Kosova është në tranzicion dhe është ende duke zhvilluar jo vetëm një kornizë të qeverisjes demokratike por edhe të edukimit të popullatës së përgjithshme mbi të drejtat, detyrat dhe mundësitë që ofrohen nga sistemi i ri i qeverisjes. Nëse dëshirojmë që këto sisteme të funksionojnë si duhet, paraprakisht duhet të ekzistojnë disa parakushte.

Ndërmjetësimi është ende në zhvillim e sipër në vendet me demokraci të fortë e stabile. Ai është zhvilluar nga praktika dhe eksperimentimi. Gjatë viteve, praktika është plotësuar nga një teori e re dhe gjithnjë në zhvillim. Prandaj, mund të pritët që kur një sistem i plotë i ndërmjetësitit vihet në zbatim në një demokraci të re, personave të ngarkuar me kryerjen e këtyre ndërmjetësimeve u duhet kohë, trajnim dhe resurse adekuate për t'iu adaptuar sistemit të ri. Për më tepër, kur sistemi të vihet në zbatim, ai me siguri mund të jetë një punë me orar të plotë për anëtarët e komiteteve të tilla. Në thelb, çfarëdo reforme e komiteteve duhet të ketë një bazë të fortë resurcesh.

### **Vrojtim**

Disa prej resurseve që duhet të mirren parasysht në mënyrë që komitetet të kryejnë punë efektive e cilësore janë: stabilimentet adekuate për ndërmjetësim, financimi për avancimin e interesave, ekspertiza ligjore, përkthimi adekuat e me kohë, financimi i rregullt për anëtarët e komitetit, trajnimi gjithëpërfshirës mbi ndërmjetësimin, qasje shërbimeve konsulente/këshillave nga Komiteti për Ndërmjetësim, si dhe stafi mbështetës për kryerjen e aktiviteteve.

Përveç parakushtit të resurseve, parimet themelore të ndërmjetësitit dhe zgjidhjes së problemeve duhet të respektohen në mënyrë që Komiteti për Ndërmjetësim të zhvillohet. Më saktësisht, e ngërthyer në procesin e ndërmjetësitit është natyra vullnetare e procesit, kredibiliteti i ndërmjetësuesit(ve), pavarësia e ndërmjetësuesit(ve). Nëse këta faktorë nuk sigurohen, është e gjykuar që ndërmjetësimi të ketë rezultate mesatare. Gjatë tërë historisë së ndërmjetësitit si një mekanizëm alternativ i zgjidhjes së kontestit, kredibiliteti nuk ishte dicka e falur, por dicka që duhej të fitohej me kalimin e kohës. Prandaj, qeveritë qendrore dhe komunale duhet të përkujdesen që procesi të fitojë kredibilitet dhe të mos pengohet për shkak të mungesës së resurseve apo të kredibilitetit. Posaçërisht, në një shoqëri e cila e ndërton kredibilitetin e vet si një demokraci tolerante, e hapur dhe shumë etnike, është me rëndësi të madhe që mekanizmat e dizajnuara për mbrojtjen dhe avancimin e të

<sup>1</sup> See UNMIK Regulation 2000/45 on Self-Government of Municipalities in Kosovo, Section 23.

drejtave të bashkësive, t'i inkurajojnë pakicat t'i shfrytëzojnë këto. Ashtu siç është deklaruar edhe në raportet e mëhershme të CSSP-së, strukturat aktuale të komiteteve edhe pse qëllim-mira e të menduara mirë, mund të jenë frikësuese e dekurajuese për ndonjë pjesëtar të pakicave posaçërisht për një banor të rëndomtë të një bashkësie. Gjatë vizitave të shumta të CSSP-së, anëtarët e bashkësive kanë shprehur dyshime në aftësinë e komiteteve të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre. Këto dyshime janë një sfidë e mëtejme në drejtim të motivimit të anëtarëve të marrin pjesë aktive.

Dyshimet mbi këto struktura bazohen në preokupimet rreth lidhjes ndërmjet komiteteve dhe Kuvendit Komunal ose organeve tjera. Në ndërmjetësim, një marrëveshje lidhur nga palët në ndërmjetësim dhe zbatohet nga vetë ata. Nëse ekzistojnë palë të jashtme të cilët ndikojnë në marrëveshje, ata duhet të kyçen në procesin e ndërmjetësimit dhe jo në procesin e miratimit. Mirëpo, strukturat aktuale, dhe lidhja me Kuvendin Komunal e le marrëveshjen në duar të Kuvendit duke shfuqizuar kështu palët në marrëveshje. Një proces i tillë e dekurajon një pjesëtar të pakicave për shkak të perceptimit se pavarësisht nga ajo që është vendosur me ndërmjetësim, shumica ende ka mundësinë të refuzojë marrëveshjen përmes Kuvendit. Në këtë drejtim është me rëndësi të shihet nëse mund të bëhet një ndarje lidhur me llojet e ankesave për të cilat vendim-marrja duhet të bëhet nga institucionet apo organet tjera. Organet specifike të kyçura në konflikt duhet të përfaqësohen si palë në ndërmjetësim dhe të jenë të gatshëm të bëjnë zotime të forta. Ndërmjetësimi për të cilën kërkohet vota e Kuvendit Komunal ka tendenca të bëhet më shumë një ndërmjetësim politik dhe është më së miri t'i besohet ndonjë Njësitit Komunal për Ndërmjetësim të përbërë nga partitë politike. Në rastet e tilla, një rekomandim i Komitetit për Komunitete drejtuar Kuvendit Komunal do të ishte më i qëlluar sesa procesi i ndërmjetësimit për të cilën nevojitet aprovim. Në këtë drejtim, Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut janë të heshtura lidhur me atë se çfarë ndodh me arritjen e ndonjë marrëveshjeje për ndërmjetësim dhe në çfarë forme (marrëveshje, konkluzë, rekomandim, etj.) duhet të formulohet marrëveshja.

### **Vrojtim**

Është me rëndësi të arrihet një barazpeshë ndërmjet pavarësisë së Komitetit për Ndërmjetësim për të arritur një marrëveshje të pranueshme nga të dyja palët dhe përgjegjësitë e Kuvendit Komunal. Më shumë punë duhet të bëhet për të definuar:

- (1) Cilat janë palët?
- (2) Kush i merr vendimet?
- (3) Çfarë ndodh pas arritjes së marrëveshjes për ndërmjetësim?
- (4) A është e domosdoshme që Kuvendi Komunal ta konfirmojë marrëveshjen?

Përveç resurseve dhe pavarësisë, kredibiliteti bazohet në aftësitë e ndërmjetësuesve për ndërmjetësim. Paaftësia kohë pas kohe është ngritur si një problem i madh e të dyja komiteteve. Edhe pse teknikisht është e vërtetë që shumë anëtarë të këtyre komiteteve nuk kanë dije të nevojshme për përmbushjen e detyrave të komiteteve, mosaftësia mban me vetë një konotacion negativ që injoron faktorin kyç që shumica e anëtarëve mundohen të kryejnë detyrat me ato pak dije që posedojnë në një sistem që mandatohet nga autoritetet më të larta. Për më tepër, një numër i madh i tyre janë po të njëjtët persona që ngarkohen me detyrë të implementimit të ndonjë reforme. Prandaj, nëse dëshirojmë që një reformë të ketë sukses në pikësynimet e saj duhet të vihet më shumë theks në identifikimin e dijeve të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrave. Për më tepër, është me rëndësi të rriten resurset e këtyre komiteteve fillimisht, për të siguruar trajnim, mbikëqyrjen, këshillim dhe mbështetje adekuate. Një theks i veçantë duhet të vendoset në trajnime të specializuara për anëtarët e komitetit për një periudhë më të gjatë kohore. Trajnimi nuk mund të jetë trajnim një-herësh apo vetëm një tërësi dokumentesh. Qeveria qendrore do të mund të angazhonte një përzjerje të trajnerëve vendor e ndërkombëtarë për të ofruar një trajnim të cilësisë së lartë, bartje të dijes dhe qëndrueshmëri të sistemit.

Aktualisht IPVQ-ja është duke shqyrtuar miratimin e një projekt Ligji për Ndërmjetësim. Nëse miratohet ky ligj, do të jetë një zhvillim shumë pozitiv dhe do të rris edhe më tej kredibilitetin e ndërmjetësimit në Kosovë, posaçërisht duke marrë parasysh se për ndërmjetësim të suksesshëm kërkohen ndërmjetësues të aftë. Mirëpo, mbetet e paqartë çfarë lidhjesh do të ketë ndërmjet ligjit, komiteteve për ndërmjetësim, ndërmjetësuesve profesional, si dhe Shoqatës së Ndërmjetësuesve. Është poashtu e paqartë çfarë roli do të ketë Këshilli i propozuar i Ndërmjetësimit në mbikëqyrjen e komiteteve për ndërmjetësim, një rol kyç që do të ishte i dobishëm dhe i domosdoshëm. Është me rëndësi thelbësore që Ministria e Pushtetit Lokal dhe ajo e Drejtësisë të zhvillojnë një stuhë mendimesh lidhur me kundërthëniet apo plotësimet e mundshme në këtë drejtim.

CSSP-ja është e mendimit që ekzistojnë interesa të ndërthurura ende të paidentifikuara në krijimin e lidhjeve ndërmjet Komiteteve komunale për Ndërmjetësim, Këshillit për Ndërmjetësim, Shoqatës së Ndërmjetësuesve dhe ndërmjetësuesve profesional. Pjesëmarrja e ndërmjetësuesve profesional në proces do të rris kredibilitetin e procesit të ndërmjetësimit dhe do të lehtësojë barrën e anëtarëve të komiteteve. Në të njëjtën kohë, ajo do të rris kredibilitetin e ndërmjetësimit si një profesion në Kosovë dhe do të ofrojë një nismë për një profesion që ende është në zhvillim e sipër. Në këtë drejtim është me rëndësi të mirret parasysh trajnimi i veçantë mbi “ndërmjetësimin në bashkësi” për ndërmjetësues të specializuar të certifikuar. Për më tepër, një proces ndërmjetësimi i definuar qartë, nën mbikëqyrjen e një organi më të lartë të ndërmjetësimit, siç është Këshilli për Ndërmjetësim, do të rris efektivitetin e

sistemit dhe do të zvogëlojë barrën e qeverisë komunale kur të vendos se cilat marrëveshje të ndërmjetësimit të pranojë. Një sistem i thjeshtëzuar, i organizuar mirë dhe i pajisur me trajnim adekuat do të bëjë punë të madhe në riparimin e dëmit kredibilitetit të komiteteve dhe do t'i nxis individët ta shfrytëzojnë sistemin. Me rritjen e kredibilitetit, në aspektin afatmesëm mund të identifikohen edhe rritjet gjegjëse në vullnetin e mirë politik dhe në përgjegjësinë.

### Vrojtim

Nëse dëshirojmë që ndërmjetësimi si profesion të ketë sukses, është me rëndësi thelbësore që qeveritë qendrore, komunale, dhe organizatat ndërkombëtare të mendojnë sesi më së miri ta inkorporojnë atë në proces dhe ta mbështesë duke i dhënë punë. Në këtë drejtim, Shoqata e propozuar e Ndërmjetësuesve dhe Ndërmjetësues të Certifikuar mund të kenë role domethënëse në ndihmë të Komiteteve komunale për Ndërmjetësim.

### Komitetet për Komunitete dhe për Ndërmjetësim

Pjesët e mësipërme shtjelluan çështjet e kredibilitetit, resurseve, pavarësisë dhe rolit të ndërmjetësuesve profesional, të gjitha këto parakushte për funksionimin e duhur të komiteteve. Nëse dëshirojmë që këto komitete t'i arrijnë qëllimet e veta, struktura duhet të jetë e thjeshtë, e qartë dhe efikase. Problemi momentalisht është që qëllimet e ndryshme janë bashkuar në një strukturë që është komplekse dhe hutuese. Në këtë strukturë mund të identifikohen tre qëllime të veçanta: shqyrtimi i rregulloreve komunale në rast të ndonjë shkeljeje të të drejtave (**aktiv**), zgjidhja e konflikteve bazuar në shkelje të mundshme të të drejtave (**reaktiv apo reagues**), avancimi i të drejtave dhe interesave (**pro-aktiv**).

Është mendimi i CSSP-së që është shumë e dyshimtë se një person me një diplomë fakulteti, përvojë të madhe demokratike politike ose organizative, ose me trajnim mbi aftësitë e zgjidhjes së problemeve mund t'i plotësojë pritjet e parashikuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 (dhe Udhëzimet pasuese Administrative të UNMIK-ut).<sup>2</sup> Për më tepër, çdo Udhëzim Administrativ shtesë i lëshuar, synonte zgjidhjen e konfliktit por joqëllimisht mund t'i ketë komplikuar gjërat duke u munduar të përmirësojnë një sistem që ish me të meta që në themel. Dy pjesët në vijim do të shqyrtojnë punën e komiteteve dhe të identifikojnë disa pyetje dhe çështje të ngritura nga struktura aktuale.

<sup>2</sup> See previous CSSP reports on this issue.

## **Komiteti i Komuniteteve**

Komiteti i Komuniteteve ka tre role: të shqyrtojë tërë legjislacionin komunal dhe të jep rekomandime adekuate (**aktiv**); të shqyrtojnë ankesat individuale që kanë të bëjnë me diskriminimin apo shkeljen e të drejtave (**reagues**); dhe të avancojnë të drejtat dhe interesat e bashkësisë (**proaktiv**). Cdonjëra prej këtyre detyrave është një punë me orar të plotë për komitetin nëse dëshirojmë të kryhen mirë. Shqyrtimi i legjislacionit komunal, nëse bëhet si duhet, mund të konsumojë një rend të tërë të ditës në një takim të Komitetit për Komunitete.<sup>3</sup> Së dyti, roli reagues i komitetit mund të pengohet paksa në hetimin e shkeljeve. Çfarë rregulla të punës duhet të përdorin në një hetim; mbi çfarë baze bëhet hetimi dhe kush e kryen atë? Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2003/002 neni 5.3, e shtjellon këtë çështje gjërësisht. Mirëpo, hetimi i shkeljes së të drejtës kërkon një shkallë të caktuar të diturisë ligjore, trajnim apo ekspertizë, gjë që mungon. Për më tepër, afatet për procedurat hetimore janë të paqartë në Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut. Si rezultat i kësaj, Komiteti i Komuniteteve shpesh nuk i përcjellin rastet Komitetit për Ndërmjetësim dhe nuk i debatojnë problemet. Në vend të kësaj, anëtarët e komitetit përpiqen t'i zgjidhin vetë problemet, në dëm të roleve tjera proaktive dhe aktive të komiteteve.

Një çështje për brengosje është nëse Komitetet për Komunitete janë vendi i duhur për hetimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut ose nëse organet tjera gjyqësore apo gjykatat janë vendet më të qëlluara. Shpesh akuzat për shkeljet janë të ngjajshme në të gjitha komunat. Me këtë rast, parashtrohet pyetja nëse mekanizmat e ombudspersonit duhet të zgjërohen dhe të forcohen për t'u ballafaquar me këto çështje. Kjo nuk nënkupton që komiteti nuk ka ndonjë rol në këso rastesh. Mirepo, duhet të mirret parasysh rishqyrtimi i rolit të institucionit të ombudspersonit në raport me këtë komitet gjatë reformimit të tij.

### **Pyetjet për t'u marrë në konsideratë**

- (1) Nëse është bërë shkelje e të drejtave, a është e drejtë të shfrytëzohet ndërmjetësimi për zgjidhjen e problemit?
- (2) Ose, a varet mbrojtja e të drejtave të njeriut në një sistem gjyqësor që i shqyrton shkeljet dhe në atë mënyrë cakton presedane se një shkelje në një komunë nuk mund të përsëritet në ndonjë vend tjetër?

Përvec procedurave hetuese, komiteti poashtu ka për detyrë të avancojë interesat dhe të drejtat e komitetit. Kjo qasje proaktive është përmendur në dokumentet e ndërlidhura por nuk i është dhënë ndonjë fushëveprim apo domethënie qenësore. Këtu ka tendenca që çështja të zvogëlohet vetëm në financa dhe aftësinë e disa

<sup>3</sup> CSSP's experience with municipal institutions has been that there are also related issues to consider, such as the lack of appropriate and timely translation, which delay the committee's ability to respond appropriately.

njerëzve të avancojnë vetëdijen dhe të drejtat e bashkësisë. Një argument është se Zyra e Bashkësive pranon një shumë të caktuar të hollash dhe ka punëtorë në dispozicion për këso aktivitetesh. Mirëpo, hulumtimet nga vizitat e mëhershme të CSSP-së dëshmojnë se kjo Zyrë për Bashkesi është shumë e zënë duke u marrur me probleme individuale dhe me identifikimin e projekteve zhvillimore. Hulumtimet poashtu tregojnë se një shumë e vogël e të hollave shpenzohet në avancimin e interesave dhe të drejtave, ndërsa shumica e të hollave shpenzohen në projekte zhvillimore siç janë elektrifikimi, rrugët, infrastruktura, shtëpitë, etj. Edhapse këto të gjitha janë shpenzime të vlefshme, ata do të duhej të ishin shpenzime të rregullta komunale zhvillimore, përveç nëse ka ndonjë aspekt të veçantë komunitar që nuk është parashikuar me planet komunale zhvillimore.

#### **Pyetjet për t'u marrë në konsideratë**

- (1) Si duhet të akordohen resurset për bashkësitë?
- (2) Si mund t'i shfrytëzojë Komiteti i Komuniteteve OJQ-të dhe shoqërinë civile për t'i avancuar interesat dhe të drejtat?
- (3) A duhet Komiteti i Komuniteteve të luajë vetëm një rol mbikëqyrës apo edhe atë koordinativ?
- (4) A duhet Komiteti i Komuniteteve të ketë një njësi më të vogël në kuadër të Komitetit vetëm për veprimtaritë proaktive?
- (5) A është Komiteti i Komuniteteve vendi i duhur për t'i shqyrtuar akuzat e shkeljes ose kjo duhet të jetë përgjegjësi e Komitetit për Ndërmjetësim?
- (6) A duhet Komiteti i Komuniteteve të shqyrtojë vetëm rregulloret komunale dhe avancimin e të drejtave dhe interesave?

Roli i tretë dhe më i zhvilluar i komitetit është shqyrtimi i rregulloreve komunale. Nëse ky rol kuptohet drejtë sipas Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2003/002, është ky një rol shumë aktiv pasi që në teori asnjë rregullore nuk mund të miratohet pa mendimin dhe rekomandimet e Komitetit për Komunitete. Në këtë drejtim, çështja e kohës, përkthimit cilësor e me kohë, dhe të kuptuarit e procedurave që vlejnjë përkitazi me rregulloret, ndikojnë në punën e komitetit. Duke marrë parasysh që komiteti zakonisht takohet një herë në muaj, por ka vetëm një afat dy javor për të reaguar ndaj rregulloreve të miratuara, kjo prezanton problem. Detyrat në këtë drejtim marrin shumë kohë dhe varen shumë nga vullneti i mirë i Kuvendit Komunal ta shikojnë Komitetin e Komuniteteve si një pjesë përbërëse të procesit ligjvënës. Një çështje që duhet të shqyrtohet është nëse Kuvendi Komunal mund të anashkalojë komitetin apo duhet të obligohet të pret përgjigje nga komiteti.

### **Komiteti për Ndërmjetësim**

Funksioni i vetëm i Komitetit për Ndërmjetësim është që të ndërmjetësojë në rastet e shkeljes së të drejtave, raste këto që i referohen nga Komiteti për Ndërmjetësim. Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2005/001 është i paqartë se çfarë duhet të bëhet në rast të ndërmjetësimit të suksesshëm. Pjesa 7 e këtyre udhëzimeve vetëm përmend raportin në Kuvendin Komunal sesi duhet të zgjidhet çështja. Prandaj, mbetet e paqartë nëse qëllimi është ndërmjetësimi i suksesshëm apo rekomandimi bazuar në pjesëmarrjen e palëve në konflikt. Ky dallim apo kjo ndarje është me rëndësi pasi që definojnë procesin dhe epilogun e tij. Mirëpo, problemi kryesorë i Komitetit për Ndërmjetësim është se që nga themelet e tij teorike komitetit i është dhënë një detyrë që është sfiduese ndërsa në të shumtën e rasteve edhe e pazbatueshme përbrenda kornizës së parashikuar. Nga këndvështrimi metodologjik korniza ka tre probleme: (1) përkufizimi, (2) pavarësia, dhe (3) funksioni. Cdonjëra prej këtyre e pengon efektivitetin e komitetit ndërsa së bashku mund të krijojnë probleme për procesin e ndërmjetësimit, të cilin qeveria qendrore përpiqet ta themelojë.

Lloji i ndërmjetësimit dhe roli i tij nuk janë definuar qartë. Një përkufizim i thjeshtë dhe i pranuar gjërisht i ndërmjetësimit është se ai është një process ku një palë e tretë që nuk është kyçur në konflikt u ndihmon palëve në arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme për të dyja palët. Domethënia e këtij përkufizimi përfshin neutralitetin e ndërmjetësuesit, dhe bindjen se ndërmjetësuesi nuk ka një rol vendim-marrës. Me këto koncepte në mendje, parashtrohen disa pyetje.

#### **Pyetjet që duhet të mirren në konsideratë**

- (1) A munden anëtarët e Komitetit për Ndërmjetësim të jenë neutral kur çështjet e bashkësisë i prekin vetë ata ose kur ata janë anëtarë të Kuvendit Komunal?
- (2) A mundet Komiteti për Ndërmjetësim të jetë neutral kur ka rolet hetuese dhe ato rekomanduese?
- (3) A mund të negociohen apo të ndërmjetësohen shkeljet e të drejtave?
- (4) A do të jetë i ndryshëm ndërmjetësimi i kryer nga komiteti prej atij të propozuar me projekt Ligjin për Ndërmjetësim?
- (5) Cka është “Ndërmjetësimi në Bashkësi”?

Këto pyetje duhet të mirren parasysh në lidhje me konceptin e “Komitetit për Ndërmjetësim”. Kjo formë e ndërmjetësimit mund të definohet me një formë tjetër ndërmjetësimi, për shembull me “Ndërmjetësimin në Bashkësi”, për t’u përkujdesur që popullata e gjërë ta kuptoj dallimin midis tij dhe ndërmjetësimit privat apo komercial. Në këtë rast, duhet të kërkohet më shumë përvojë në ndërmjetësimin në bashkësi në

teren, si praktikë që zhvillohet në shumë pjesë të botës. Një çështje që është me rëndësi qendrore për ndërmjetësimin bashkiak që fakti që roli i ndërmjetësimit nuk është të hetojë por të ndihmojë. Nëse një palë beson se të drejtat e tij/të saj janë shkelur, shkelja është bërë në kuptimin apo perceptimin e individit dhe roli i ndërmjetësuesit është t'u ndihmojë palëve në zgjidhjen e kontesteve qofshin të perceptuara apo faktike. Mospërfillja e ankesës shërben vetëm për vërtetuar mendimin e palës së diskriminimi është sistematik dhe se individi është i pafuqishëm. Prandaj, nëse Komiteti për Ndërmjetësim dëshiron t'u ndihmojë bashkësive lokale në zgjidhjen e kontesteve, ai duhet t'i shqyrtojë elementet objektive dhe subjektive të konfliktit.

Cështja e pavarësisë së Komitetit për Ndërmjetësim është një pyetje qendrore për ekzistimin e vazhdueshëm të komitetit. Dy nën-çështje janë brengosëse: lidhjet e komitetit me Kuvendin Komunal dhe aftësia për ndërmarrjen e vetë-iniciativave. Me vetë faktin se anëtarët e Kuvendit Komunal janë anëtarë të Komitetit, ushtrohet një ndikim jo i duhur në proces, posaçërisht për shkak të bindjeve të tyre partiake. Për më tepër, ndërmjetësimi bazohet në një marrëveshje të pranueshme për të dy palët dhe duhet të zbatohet nga palët në konflikt. Prandaj, marrëveshjet e arritura në Komitetin për Ndërmjetësim të cilat duhet të kalojnë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa dhe përmes Kuvendit Komunal kanë prirje për vonesa, ri-negocijim apo dështim. Këto probleme edhe më tej e diskreditojnë punën e komitetit dhe i dekurajojnë individët në përdorimin e mundësive që i ofron komiteti. Problemi i tretë i ndërlidhur me pavarësinë është kufizimi i Komitetit për Ndërmjetësim në çështje që i dërgohen nga Komiteti i Komuniteteve. Ankesat mund të shqyrtohen vetëm nëse rastet i percillen komitetit. Më e rëndësishmja është pavarësia e komitetit për të vendosur fushëveprimin e punës së vet dhe të ketë qasje në popullatë të gjërë nëse dëshirojmë që procesi të jetë i dobishëm. Poashtu, janë edhe disa funksione të ndërthurura hetimore me Komitetin e Komuniteteve që do të mund të kanalizoheshin.

#### **Pyetjet që duhet të mirren në konsideratë**

- (1) A ekziston ndonjë mënyrë për të arritur pavarësinë e komitetit?
- (2) A është e dobishme të zgjerohet fushëveprimi i komitetit për të përfshirë edhe mundësinë e shqyrtimit të kërkesave nga shoqëria civile, OJQ-të, individët dhe institucionet komunale (arsim, shëndetësi, shërbime komunale, etj.)?
- (3) A është Kuvendi Komunal institucioni i duhur për të aprovuar marrëveshjet që arrihen nga të dyja palët?
- (4) A mund të jenë politikanët neutral e të paanshëm?
- (5) A duhet mandati i anëtarëve të shkëputet prej procesit elektoral?

- (6) A duhet t'i parashtrihen ankesat për shkelje dhe kërkesat për ndërmjetësim drejtpërsëdrejti Komitetit për Ndërmjetësim, i cili edhe ashtu duhet t'i hetojë ankesat?

Problemi i tretë me Komitetin për Ndërmjetësim ka të bëjë me çështjet e lartëpërmendura por përqendrohet në funksionet teknike të komitetit. Në veçanti, ekzistojnë preokupime lidhur me aftësinë e anëtarëve të komitetit që t'i kryejnë rolet e veta në mënyrë të kënaqshme dhe t'i përmbushin pritjet e qeverisë në rrafshin e rezultateve. Kur komiteti bën ndërmjetësim ndërmjet dy apo më shumë palëve ekziston rreziku i komplikimit të ndërmjetësimit jashtë çdo kontrolli dhe të ngrit nivelin e kompleksitetit për anëtarët që janë ose të paarsimuar ose jo të certifikuar për ndërmjetësim. Projekt Ligji mbi Ndërmjetësim propozon që në të ardhmën ndërmjetësuesit e certifikuar të kenë të paktën diplomë univerzitare dhe trajnim adekuat. Qëllimi prapa kësaj kërkeseje apo nevoje është bindja se ndërmjetësimi kërkon një përvojë dhe aftësi profesionale të caktuar, të cilën momentalisht anëtarët e komitetit nuk e kanë. Prandaj, një mundësi që do të duhet të shqyrtohet është që Komiteti për Ndërmjetësim të ketë një rol mbikëqyrës por ndërmjetësimi të bëhet prej dy apo tre ndërmjetësues të specializuar.

Është mjaft e dyshimtë që komitetet me anëtarë më përkatësi të ndryshme partiake e me trajnim minimal të jenë në gjendje të ndërmjetësojnë për një problem me aftësitë e nevojshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Poashtu, procesi i ndërmjetësimit i cili ngërthen hetime, këshilla juridike, dhe përfaqësues, ashtu siç parashikohet me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2005/001, formalizon një proces joformal dhe e shkrin kufirin ndërmjet ndërmjetësimit dhe procedurave gjyqësore apo arbitrimit, dhe do të kërkonte trajnim edhe më të specializuar për të arritur ndërmjetësim të duhur.

#### **Pyetjet që duhet të mirren në konsideratë**

- (1) Sa ndërmjetësues duhet të jenë të kyçur kur rasti për ndërmjetësim i parashtrihet komitetit?
- (2) Çfarë trajnimi apo certifikimi duhet t'iu ofrohet anëtarëve të komitetit?
- (3) Çfarë është lidhja ndërmjet ligjit të ardhshëm mbi ndërmjetësimin, ndërmjetësues profesional dhe mbi Komitetin për Ndërmjetësim?
- (4) A ka ndonjë rol për ndërmjetësues profesional?

Të gjitha pyetjet e parashtruara në këtë raport nuk duhet të interpretohen si argumentim kundër ndonjërit apo të dyja komiteteve. CSSP është e vetëdijshme se është duke u bërë rishqyrtimi i strukturave të komiteteve. Problemi është që pritjet e mëdhaja dhe pakënaqësia me komitetet kanë krijuar një situatë ku çdo reformë do të shihej me skepticizëm dhe me kritika drejtuar anëtarëve të komitetit, të cilët janë

ballafaquar me strukturën që u është imponuar. Anëtarët janë po ata persona që do t'iu kërkohet me siguri të jenë përgjegjës për zbatimin e çfarëdo reforme të komitetit dhe kontributi i tyre është i vlefshëm. Për më tepër, nëse reforma nuk i arrin rezultatet e dëshiruara, komitetet do të humbin edhe më shumë kredibilitet ashtu siç do të humbet edhe besimi i prijësve bashkiak në sistemin.

**Është me rëndësi thelbësore që procesi i reformimit t'i shqyrtojë çështjet e lartëpërmendura me kujdes me qëllim të zhvillimit të një sistemi që e avancoon mbrojtjen e të drejtave dhe interesave, ngrit kredibilitetin në vetë-qeverisjen lokale, dhe që i thjeshtëzon strukturat aktuale duke e ngritur njëkohësisht cilësinë dhe standardet.**

Çështjet e ngritura në këtë pjesë të raportit janë përpiluar dhe vendosur në një shtojcë për lehtësinë e lexuesit. Pyetjet nuk janë të plota por janë bërë me synim të nxisin impulsin dhe të menduarit. Poashtu, pjesa e ardhshme përqëndrohet në krijimin e opsioneve lidhur me ristrukturimin e komiteteve.

### **Krijimi i Opcioneve**

Pjesa e ardhshme e këtij raporti do t'i identifikojnë opsionet e mundshme për shqyrtim kur të diskutohen reformat e Komitetit të Komuniteteve dhe atij për Ndërmjetësim. Një prej parimeve kryesore të ndërmjetësimit dhe negociimit është se hulumtimi i përbashkët i opsioneve dhe vendim-marrja mbasin në duart e negociatorëve. Prandaj, CSSP nuk synon të avancojë ndonjë zgjidhje si ideale, por të prezantojë opsione dhe ide të ndryshme si bazë për diskutimin e modeleve të mundshme të reja për reformimin e Komiteteve për Komunitete dhe Ndërmjetësim. CSSP ka identifikuar tre opsione dhe ide të ndryshme që do të mund të ishin të dobishme. Të tre opsionet janë të bazuara në tre pyetje: Cka është qëllimi? Cila është struktura? Cka nevojitet?

## Opcioni 1: Komitetet e Ndara

### QËLLIMET

- Të shkëputen dhe të qartësohen rolet e Komitetit për Komunitete dhe për Ndërmjetësim;
- Të arrihet fushëveprimi dhe aktivitetet e pavarura; dhe
- Të krijohet një barazpeshë ndërmjet detyrave/përgjegjësiave dhe resurseve.

### STRUKTURA

#### Komitetet për Komunitete

- Komiteti për Komunitete e ka të kufizuar fushëveprimin, dhe atë në monitorimin e të gjitha rregulloreve komunale dhe sjelljen e institucioneve komunale (aktiv) si dhe avancimin e interesave dhe të drejtave të bashkësive të ndryshme (proaktiv).
- Komiteti ka mandate të shqyrtojë të gjitha institucionet komunale (shërbimet komunale, shkollat, klinikat shendetësore, etj) për t'u përkujdesur që politikat të mos jenë diskriminuese.
- Komitetit t'i alokohet një buxhet i veçantë për fushata promovuese (broshura, media, shtyp, ngjarje, etj.)
- Komitetit i jipet një rol mbikëqyrës për veprimtarinë e Zyrës për Bashkësi për t'u përkujdesur që një pjesë e barabartë e të hollave të dhënë Zyrës për Bashkësi të shpenzohen për këtë qëllim.
- Thelbësor për punën e komitetit është përkthimi adekuat e me kohë i dokumenteve komunale.
- Komitetit t'i jipet qasje e plotë ekspertizës ligjore (komunale, ministrore, ombudspersonave, etj.).

#### Komiteti për Ndërmjetësim

- Komitetit për Ndërmjetësim t'i jipet detyrë e plotë e pranimit dhe përpunimit të ankesave mbi shkeljen e të drejtave (reaktiv) dhe t'i përcjell ankesat për masat adekuate.
- Komiteti shfrytëzon ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve (proaktiv).
- Kërkesat mund të parashtrihen nga Komitetit për Komunitete, institucione komunale, OJQ, dhe individë.

- Ankesat kategorizohen (private, komerciale, institucionale, të bashkësisë, sociale, etj.). Varësisht prej llojit të ankesës, komiteti mund të ndërmerr masa adekuate apo t'i bëj rekomandime parashtruesit te ankesës.
- Shqyrtohet roli i ndërmjetësuesve profesional (si anëtarë të komitetit apo si këshilltarë), ose trajnimi i specializuar për “ndërmjetësimin në bashkësi).
- Lidhur me strukturën e komitetit, është e dobishme të shqyrtohen format e ndryshme të ndërmjetësimit në bashkësi.
  - Një mundësi për të shqyrtuar është që të emërohet komiteti i përhershëm prej 12 ndërmjetësuesve të certifikuar që janë të gatshëm të ndërmjetësojnë dhe të takohen për të biseduar rastet; vetë ndërmjetësimi kryhet nga 3 ndërmjetësues. Çdo palë në konflikt do të përzgjedh një ndërmjetësues nga komiteti ndërsa dy të zgjedhurit e emërojnë të tretin varësisht prej natyrës së ankesës.
  - Komiteti të ketë rol mbikëqyrës dhe koordinues.
- Komiteti është i ndërlidhur me ndërmjetësimin në bashkësi dhe e ka të ndaluar të ndërmerr ndërmjetësime komerciale apo private.
- Rastet kur ndërmjetësimi privat është i duhur i referohen Shoqatës së Ndërmjetësuesve.
- Komiteti për Ndërmjetësim takohet rregullisht.

### **NEVOJAT**

- Projet Ligji mbi Ndërmjetësimin duhet të ngërthejë dispozitat lidhur me Komitetin për Ndërmjetësim dhe bashkëveprimin ndërmjet ndërmjetësuesve profesional dhe Komiteteve për Ndërmjetësim.
- Ose, anëtarët e Komitetit për Ndërmjetësim duhet të kryejnë kurs të specializuar ndërmjetësimi mbi “ndërmjetësimin në bashkësi”.
- Komitetet për Komunitete duhet të kenë udhëzime më të qarta mbi avancimin e interesave.
- Të gjithë anëtarët e të dyja komiteteve u duhet më shumë trajnim, posaçërisht trajnim i përbashkët.
- Nevojitet më shumë financim për rolin proaktiv të Komitetit për Komunitete.

## **Opcioni 2: Komiteti i Përbashkët**

### **QËLLIMET**

- Konsolidohen komitetet në një sistem
- Të rritet efektiviteti.
- Të mundësohet ndërmjetësimi profesional.

### **STRUKTURA**

- Krijohet një komitet që kryen detyrat e dy komiteteve (aktive, reaktive, dhe proaktive).
- Komiteti ka dy shtylla: komitetin e përhershëm dhe një regjistër të ndërmjetësuesve profesional të akredituar për komitetin, që zgjidhen sipas nevojës.
- Anëtarët e përhershëm kanë përgjegjësi për pranimin e ankesave mbi shkeljet, të avancojnë të drejtat dhe interesat dhe të shqyrtojnë rregulloret.
- Komiteti është përgjegjës për te hetimin e ankesave dhe përpunimin e tyre.
- Vetë anëtarët e komitetit nuk e kryejnë ndërmjetësimin.
- Regjistri i ndërmjetësuesve të certifikuar është në dispozicion sipas nevojës.
  - Për të mundësuar një përfaqësim të duhur, regjistri do të ketë një vend të rezervuar për dy ndërmjetësues nga rradhët e çdo bashkësie.
  - Me rritjen e numrit të ndërmjetësuesve të certifikuar në Kosovë, regjistri bën rotacion të emrave, për shembull, çdo tre vjet.
  - Personat që kualifikohen si ndërmjetësues duhet t'i plotësojnë disa kriteriume (trajnim, i pa-anshëm, përvoja, etj.).
  - Ky opcion poashtu do t'i inkurajonte personat në bashkësi të aftësohen si ndërmjetësues në profesionin e sapolindur të ndërmjetësuesve në Kosovë.
- Me përfundimin e ndërmjetësimin, komiteti i përpunon rezultat, përfshirë edhe vazhdimësinë e të njejtave.
- Një njësi më e vogël në kuadër të komitetit ka për detyrë avancimin e interesave.
- Njësia e dytë përqëndrohet në shqyrtimin e rregulloreve komunale dhe veprimtarinë e institucioneve komunale.
- Komiteti takohet rregullisht.

## **NEVOJAT**

- Miratimi i Ligjit mbi Ndërmjetësimin.
- Identifikimi i trajnimit të specializuar mbi “ndërmjetësimin në bashkësi”.
- Krijimi i një njësie më të vogël me rregulloren e vet të punës.
- Rritja e financimit për komitetin.
- Përpilimi i regjistrit të ndërmjetësuesve.
- Përpilimi i rregullave mbi procesin e ndërmjetësimit

### **Opcioni 3: Dhënia nën Kontratë e Ndërmjetësimit Komunal**

#### **QËLLIMET**

- Përqëndrimi në rolet **aktive** dhe **reaktive** të Komitetit të Komuniteteve;
- Të forcohet “ndërmjetësimi profesional në bashkësi”, dhe
- Të specializohen aftësinë e komitetit në mbrojtjen e të drejtave dhe avancimin e interesave.

#### **STRUKTURA**

- Qeveria qendrore shqyrton mundësinë e largimit të “ndërmjetësimit” si funksion i qeverisë komunale.
- Më shumë theks dhe resurse vihen në inkurajimin qendrave për “ndërmjetësim në bashkësi” në çdo komunë.
- Komitetet për Komunitete hetojnë ankesat e shkeljeve dhe japin rekomandime të duhura institucioneve komunale, pavarësisht nga procesi i ndërmjetësimit.
- Komiteti i përcjell aneksat e shkeljeve ombudspersonit ose qendrës për ndërmjetësim në bashkësi.
- Miratohen rregulloret që u lejojnë zyrtarëve komunal të kyçen të paktën në procesin e ndërmjetësimit si alternativë masave gjyqësore kur rekomandimi i Komitetit të Komuniteteve e mbështet këtë.
- Kuvendeve Komunale u ndalohet miratimi i rregulloreve që nuk janë aprovuar nga Komiteti, apo kur së paku Komiteti të ketë dhënë një mendim.
- Komitetit të Komuniteteve i jipen afate kohore rigorozë për të mundësuar shtyerjen e procesit përpara.
- Qeveria qendrore shqyrton mundësinë e dënimeve nëse nuk respektohen afatet kohore, apo nëse nuk kryhet përkthimi apo plotësohen kushtet teknike.
- Ombudspersoni luan një rol aktiv në shqyrtimet e Komiteteve për Komunitete.
- Komiteteve për Komunitete u ngarkohet detyrë e shqyrtimit të politikave për të gjitha institucionet komunale, siç janë shërbimet komunale, ndërmarrjet shoqërore, kujdesi shëndëtesor, arsimit, etj.
- Themelohet njësi për avancimin e të drejtave.

#### **NEVOJAT**

- Trajnimi i specializuar për anëtarët e komiteteve.
- Zgjerimi i Zyrës së Ombudspersonit.

- Financimi specifik për avancimin e interesave dhe të drejtave.
- Themelimi dhe mbështetja për “ndërmjetësimin në bashkësi” nga ana e qeverisë qendrore.
- Mbikëqyrja e Qendrave të Bashkësisë nga ana e qeverisë qendrore.

## Konkluzioni

Përkundër vonesës aktuale në negociatat mbi statusin e Kosovës, jeta ditore në nivel lokal ec përpara dhe reformat vazhdojnë së zbatuari. Trendi ec kah qëllimi që vetë-qeverisja lokale t'i përmbush nevojat e popullatës dhe të mbrojë të drejtat e tyre si individë dhe si anëtarë të bashkësive të tyre. Në vitin e kaluar është bërë shumë punë dhe vërehet përmirësim i dukshëm në cilësinë e punës në nivel komunal. Një sferë që duhet të mirret parasysh momentalisht është reforma e Komitetit për Komunitete dhe atij për Ndërmjetësim si dhe raporteve të tyre me organet tjera komunale. Sesi thjeshtëzohen këto komitete për të qenë më efektive, të ofrojnë më shumë shërbime dhe të prodhojnë më shumë rezultate do të jetë vendimtare në zhvillimin e kredibilitetit në këtë proces.

Është me rëndësi thelbësore që donatorët ndërkombëtarë, IPVQ-ja, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që punojnë në terren t'i kontribuojnë këtij procesi dhe të mbështesin reformat me financim, trajnim dhe këshillim adekuat. Është poashtu e rëndësishme që të organizohet një takim i përbashkët i organizatave që ofrojnë trajnim mbi ndërmjetësim dhe negocijim për të diskutuar mënyrat e plotësimit të reformave dhe punës së njëri-tjetrit. Një rrjet i organizatave ndërkombëtare e lokale të ndërmjetësimit do t'i forcononin këto përpjekje dhe do t'i mbështesnin individët në këto komitete, detyra e të cilëve është t'i zbatojnë reformat e paralajmëruara. Thelbësore për këto përpjekje është miratimi i Ligjit mbi Ndërmjetësim i cili i definton qartë rolet e Shoqatës së Ndërmjetësuesve, lidhjet me ndërmjetësimin komunal dhe kontributin e ndërmjetësuesve lokal. Nëse të gjitha këto përpjekje bashkohen, Kosova do të jetë në ballë të ndërmjetësimit në nivel lokal dhe një shembull për rajonin, posaçërisht në krahasim me Evropën si tërësi.

## **Shtojca**

### **Pyetjet për Diskutimin e Ndërmjetësimit në Kosovë**

- Si përkufizohet ndërmjetësimi?
- A është ndërmjetësimi i dobishëm si pjesë e strukturave komunale? Nëse po, në ç'mënyrë?
- Cili është funksioni dhe qëllimi i ndërmjetësimit
- Çfarë ndërmjetësimi do të duhet të përdoret për t'u ballafaquar me shkeljet subjektive dhe objektive të të drejtave?
- A janë komitetet aktuale mënyra më e mirë për arritjen e qëllimeve?
- A është struktura aktuale e volitshme për demokratizim apo pengesë?
- Sa njerëz duhet të jenë të kyçur në vetë ndërmjetësimin?
- Kush duhet të kualifikohet si ndërmjetësues?
- Çfarë trajnimi apo certifikimi duhet të kenë anëtarët e komitetit?
- Si të arrihet ndërmjetësimi cilësor?
- Si të vendoset kontrolli i kualitetit në proces?
- Në çfarë çështjesh kërkohet ndërmjetësimi?
- Si zbatohen marrëveshjet e ndërmjetësimit?
- Cili është roli i neutralitetit në Komitetin për Ndërmjetësim?
- Sa pavarësi duhet të kenë Komitetet për Ndërmjetësim?
- Cili është roli i Ombudspersonit lidhur me ndërmjetësimin në rastet e shkeljes së të drejtave?
- A mund të ndërmjetësohet për të drejtat? Çfarë resurcesh nevojiten? A ka kufi në atë se çfarë mund të arrijë Komiteti për Ndërmjetësim?
- Si mund të thjeshtëzohet procesi?